



## RAPORT VJETOR

Vendi: Erseke

Programi: UNDP

Periudha: nentor14 - nentor15

Data e raportit 6/11/2015

**Pergatit: Adad Malore**

## Raport vjetor Erseke

### 1. Objektiva vjetor:

#### 1.1 Identifikimi, gjallerimi dhe **perforcimi I grupit te grave** artizane ne Erseke :

Nje situatë mbi punimet dhe pozicionin social te grupit grave

Shkembime brenda grupit, lokale e rajonale (kombetare e nderkombetare)

Formime mbi permiresimin dhe administrimin e punes se dores, zgjerim i games dhe shitjes

Nderhyrje eksperti ne drejtim te dezinjimit , marketingut, organizimit ne punime dhe shitje.

#### 1.2 **Rritja e kapaciteteve** ne drejtim te organizimit dhe promovimit te punes se dores per grupin e grave artizane Erseke

Lidhje dhe kontakte te reja brenda dhe jashte vendit (me artisan te trevave shqiptare)

Takim me njerez te biznesit nga vendi dhe diaspora

Elementet e pare te nje Plan Marketingu dhe katalogje per punime e paketime

Shoqerimi me asistence teknike dhe me komunikim te thjeshte, nje brochure

#### 1.3 **Fuqizim ekonomik I grupit** te grave permes futjes se materialeve te reja per punim et

paketim, katalogjeve koherente ( tradite + elemente moderne) dhe promovim shitjeve

Disa punime, modele per secilen per promovime ne panaire lokale, kombetare e nderkombetare (ne Korce, Gjirokaster, Tirane, Maqedoni, Mal te Zi, Itali)

Disa shitje me perparesi punime leshi( qylima...) dhe qendisma( kostume, fustane, orendi)

### 2. Misione te realizuara ne ndjekje dhe formim te grave per fuqizimin e tyre ekonomik e social

**ADAD:** Liljana ISAKAJ, Hafuz DOMI. Emanuela MECE, dhe eksperte te jashtem

### 3. Ceshtjet kryesore te trajtuara ne kete periudhe nje vjecare me qeverisjen vendore dhe grupin e grave Erseke

- **Lancimi** I projektit dhe **validimi** nga Bashkia dhe grupi I grave,
- Situata **aktuale** e punimeve (cfare okazoni per promovim, cfare kapaciteti dhe cfare interesi?), venia ne dispozicion e nje ambjenti “ *Duart e arta Kolonjare*”
- **Avancimi** i projektit dhe verifikime te reja prane Bashkise Ersek, Muzeut etnografik dhe me grupin e grave (pasurim dhe destinacion)

**Ne lancim e ne fazen e pare:** Kryetari I bashkise se Ersekës Z. Ali LAHO, vleresoi faktin qe ADAD ka ndihmuar bashkine dhe komunat perreth per hartimin e Planit Strategjik dhe sot po ndihmon grupe interesi sic eshte grupi I grave artizane te vene ne jete idete dhe propozimet e tyre ne kete Plan Strategjik. Projekti aktual nga njera ane inkurajon vleresimin e puneve dhe produkteve artizanale te grave por nga ana tjeter rrit kapacitetet e tyre per ta kthyer kete sector ne nje sector ekonomik dhe terheqes per turizmin

**Ne vazhdim dhe aktualisht** ; Kryetari I bashkise se Kolonjes Z. Arben MALo, ka arritur te vleresoje punimet artizanale dhe ka nxitur gjera te reja qe mund te perfshihen ne kete sektor per ta bere sa me terheqes per turizmin vendas e te huaj. Bashkia do te inicioje panaiere te vererave dhe produkteve lokale ne Leskovik me pjesmarrje te autoriteteve vendore e Kombetare dhe perfshirja e grupit te grave si aktore ne promovim permes punimeve te tyre qe rrisin vleren e produkteve si vera, djathi, etj.

Avancimi dhe motivimi jane rrjedhoje e shoqerimit me assistance, pervoje e eksperience. Grupi I grave ka realizuar disa shkembime ne vend dhe shkembime nderkombetar ne Struge me 8 dhe 9 gusht 2015 (Panairi i punimeve artizanale te trevave shqiptare. Ka pasur vizitore te huaj qe kane vizituar familjet e artizaneve dhe kane bere blerje interesante. Eshte nenvizuar pasurimi I dhomes etnografike nga njera ane me objekte qe mungojne dhe nga ana tjetere me elemente karakteristike (kostume per burra e gra , moshja te ndryshme dhe profesion apo raste te tjera ), aktualisht kemi nje grup GAEG te qendisjeve me motive te kostumeve dhe arendive shtepiake Kolonjare)

- **Shoqerimi me asistene, organizimi, motivimi dhe eksperience e krijuar gjate shkembimeve mes grave artizane ka bere jo vetem avancim ne dizanj dhe cilesi por dhe shitje me interesante e inkurajuese per familjet e tyre.**

Disa punime me motive kolonjare jane derguar ne panaiere te ndryshme brenda dhe jashte vendit per promovim e shitje:

**Ne vege:** jane shitur shume rrugica e copa prej leshi me cmime mjaft interesante ( rreth 800 000 lek nga shitjet e organizuara) - person kontakti V. BIBILUSHI

**Ne tantelle:** jane shitur punime per orendi dhe per dhurata( rreth 160 000 lek) dhe jane mbeshtetur me modele te reja (katalog) dhe material baze ( tri ngjyra) per prodhime me destinacion Orendi hoteli- person kontakti L. JANO

**Ne qendisje:** jane shitur 7 jelek ( per tituj nderi e falenderimi ne Ambassada te huaja) disa kostume me motive kolonjare ( per diasporen) , jane shitur objekte si canta e shalle grash ( qe shoqerojne kostume tradicionale)- rreth 1.200 000 lek dhe jane prodhuar sasi te reja me materialet e mbeshtetura nga projekti (muline 7 ngjyra, copa dhe per punim) per prodhime te reja dhe destinacion dhurata e orendi lokale, hotele e institucione- person kontakti B. JASHARI

**Ne shtize dhe punime prej thupre :** disa shitje per panaiere bujqesore ne Korce e Diber, por nuk ka interes per shitje (ka shume ne treg nga zona te ndryshme dhe nuk jane specifike per te bere diference) – person kontakti V. TELO

- **Nderhyrje eksperti ne drejtim te marketingut dhe dizenjimit, realizimi i nje broshure dhe dy katalogjeve modele e orientim per grate artizane.**

Pas disa shkembimesh dhe identifikim te problemeve te marketingut (nga materiali i perdorur deri te prezantimi ne treg) u mundesua formimi ne vaxhdim nga ekspertja e marketingut mbi hallkat e zinxhirit prodhim artizanal – dalje ne treg dhe formimi nga 2 eksperte te dizenjimit dhe orientimit. Ky formim motivoi grupin e grave ne perzgjedhje me te mire te materialit baze, ne pasurim te modeleve sa tradicionale dhe koherente e funksionale, ne orientimin e te punuarit me dore (cfare ? per ke ? ku ? dhe kur ?), ne perputhje me kerkesen apo interesin ekonomik te tyre. Formimi ka ndikuar pozitivisht ne perzgjedhje te materialit dhe modelit por ne vazhdim kjo u perfocua me mbeshtetje te grave me baze materiale dhe me kopje te katalogjeve te punuara me shume delikatese e shije (sigurisht ne funksion te permiresimit te punes tradicionale) nga 2 vajzat – eksperte ne dizenjim. Jane realizuar punime te reja sipas katalogjeve dhe mbetet per tu pare se sa do te jene interesante ne treg dhe ne destinacionet e orientuara (hotele, institucione, dhurata, agjenci promovimi e turizmi...).

- **Animimi i grupit te grave dhe perfshirja e tyre ne forume per zhvillim te qendrueshem te Kolonjes.**

Takime me perfaqesues te bashkise, te biznesit e te huaj (specialiste e turiste) per promovim dhe marketing (sugjerimet e tyre per pasurim me element te trashegimise Kolonjare dhe kapacitetin prodhues). Trajnime e shkembime mbi format e organizimit ne grup, permiresimit te modeleve ekzistuese, pasurimin me elemente te trashegimise Kolonjare e ato moderne dhe formes se tregtimit sipas motos se permiresuar : Prodhim solidar e shitje te ndershme (per informacion jane integruar dhe gra me probleme ne kete aktivitet artizanal)

Pergjegjsja e grupit te Grave Erseke ne te njejten kohe profesioniste ne punimet me dore / artizanat Znj. Bylyre Jashari dhe perfaqesueset e Bashkise Erseke Znj. Ervina Kolani dhe Anila Cycllari me mbeshtetje organizative e profesionale te ADAD kane realizuar identifikime te reja ne fshatrat perreth (sot bashkia Kolonje)- qellimi eshte te shtrihet me gjere gjeografikisht dhe game per te perfaqesuar denjesisht artizanet Kolonjare. Temat kane qene per vleresim te elementeve te trashegimise ne punime (sipas zonave brenda bashkise Kolonje), per cilesite e materialeve baze, per kushtet e prodhimit dhe te promovimit, per vendosjen e cmimit te duhur / punim dhe per format e promovim – komunikimit..

Meqenese Kolonja eshte e pasur ne trashegimi, ndoshta nder zonat me te pasura ne vend eshte propozuar qe te punohet per nje Guide Trashegimie ku artizantati zen je vend te rendesishem.

- **Pasurimi i trashegimise rurale e artizanale ne ambjentet e muzeut ne pavionin etnografik-kerkese e bashkise dhe muzeut**

Pas inventarit te objekteve ne aspekt histori, kulture e trashegimi dhe auditit te pergjegjeses se muzeut dhe ekipit te Bashkise, eshte konstatuar nje mungese e theksuar ne objekte trashegimie me gjere se artizanale. Ne kete kuader Bashkia propozon dhe eshte e gatshme per projekte qe mbeshteten ne pasurim te muzeut qe ky i fundit te jete pjese e zhvillimit te Kolonjes. Pra, nje terheqje per ta vizituar dhe nje mundesi per te promovuar artizanatin (e grupit te grave por dhe me gjere te artizaneve tjere).

#### **4. Konkluzione**

- Mje ecuri e pasur e projektit per fuqizimin ekonomik te grave Erseke

- Shkembim e mirkuptim : **Bashki - Grupi grave – aktore -ADAD**
- Qendrueshmeri e vazhdimesi me personat e kontaktit ne Bashki, E. KOLAN dhe ne grupin e grave B. JASHARI dhe komunikimi I tyre me aktore te tjere
- Promovime e njohje te reja ne vend e jashte vendit (rajon e me gjere)
- Zgjerim te minigrupeve, gra qe bashkepunojne me njera tjetren sipas produktit (vege, tantelle, qendisje etj), perfshirja dhe e grave rurale e me probleme
- Plan marketing, katalogje (punime dhe marketing), ne vazhdim ekspertise.
- Nje dhome etnografike ne Muze te Ersekës dhe nje qender e grave duar arta per tu pasuruar dhe promovuar
- Ekspozimi dhe shitja e produkteve te punuara nga grate dhe disa minigrupe/produkt
- Zgjerimi I games dhe materialit baze per punimet artizanale sipas orientimit
- Blerja e nje numri punimesh per ekspozim local e nderkombetar dhe Avancimi ne blerje materiali per Permiresim cilesie e modeli
- Shoqerim i specializuar (formime, shkembime, forume locale e rajonale, menaxhim aktiviteti)

## **5. Propozime per vazhdim**

- 5.1. *Formime te specializuara dhe shoqerim aktiviteti (assistance ne vazhdim)*
- 5.2. *Pjesmarrje ne panairë dhe forume me biznesin (fuqizim sociale ekonomik)*
- 5.3. Shoqerim me asistence dhe menaxhim aktiviteti (programme me afat shkurter e afat gjate, mbeshitetje direkte dhe ne grup per zgjerim e permiresim aktiviteti)
- 5.4. Perfshirje me te gjere ne grupin e artizaneve (nga fshatrat perreth e ne nivel Bashkie Kolonje)
- 5.5. Fuqizimi i aktivitetit artizanal dhe pasurimi i dhomes etnografike te muzeut (interes privat e publik)
- 5.6. Realizimi i nje guide te trashegimise kolonjare ku artizanati ze vend te rendesishem (audit, seminare e forume, hartim guide e shperndarje)